



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Njoftim për media

Ditën e enjte, më datë 16.04.2015, u zhvillua mbledhja e Këshillit të Autoritetit të Mediave Audiovizive, në prani të anëtarëve të mëposhtëm:

Z. Gentian Sala	Kryetar
Z. Gledis Gjipali	Anëtar
Z. Piro Misha	Anëtar
Z. Zylyftar Bregu	Anëtar

Pas shqyrtimit të çështjeve të rendit të ditës u miratuan vendimet si më poshtë:

1. “Për miratimin e rregullores për licencimin e rrjeteve numerike dhe programeve të tyre nëpërmjet procedurës “Beauty Contest”
2. “Për çeljen e procedurës së dhënies së 5 (pesë) licencave private kombëtare transmetimi audioviziv numerik sipas “Beauty Contest”
3. “Për miratimin e kriterëve të përgjithshme dhe të posaçme të Kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit të Ankesave.”

Përveç sa më sipër, u morën në shqyrtim sanksionet gjobë të vendosura ndaj subjekteve audiovizive dhe në përfundim u vendos:

1. Shfuqizimi i sanksionit gjobë ndaj televizionit kabllor “TV M&G”;
2. Shfuqizimi i sanksionit gjobë ndaj televizionit kabllor “TV Danja”;
3. Shfuqizimi i sanksionit gjobë ndaj televizionit kabllor “TV Maqellara”;
4. Shfuqizimi i sanksionit gjobë ndaj televizionit kabllor “TV HB-CA”;
5. Lënia në fuqi e sanksionit gjobë ndaj televizionit kabllor “TV Lisus”;
6. Lënia në fuqi e sanksionit gjobë ndaj televizionit kabllor “TV Hudenisht”.

Këshilli i AMA-s ra dakord të rishikojë vendosjen e sanksioneve me gjobë ndaj televizionit kabllor “TV Xhaçi” në mbledhjen pasardhëse.

Tiranë, 16 prill 2015